



QEVERISJA E BRENDSHME E ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE

Qeverisja e brendshme e organizatave të shoqërisë civile nënkupton parimet, sistemet, rregullat, mekanizmat dhe praktikat në bazë të të cilave drejtohet një organizatë. Qeverisja e mirë nënkupton që parimet dhe praktikat e qeverisjes së brendshme ofrojnë një sistem të brendshëm të kontrollit që siguron se udhëheqësit e organizatës i shfrytëzojnë burimet dhe autoritetin në mënyrë efektive dhe llogaridhënëse bazuar në vlerat e përbashkëta të organizatës.

CILAT JANË ELEMENTET KRYESORE TË ZBATUESHME NË KOSOVË?

Detyrimet ligjore që e përcaktojnë qeverisjen e brendshme kryesisht dalin nga **Ligji për Liri të Asociimit në OJQ**. Ky ligj i dallon OShC-të në shoqata dhe fondacione. Organi më i lartë drejtues i shoqatës eshtë Kuvendi i Anëtarëve, i cili duhet të takohet të paktën një herë në vit. Në Kuvendin e Anëtarëve përfaqësohen të gjithë anëtarët e OShC-së (ose me nga një anëtar të gjitha organizatat anëtare, në rastet kur shoqata eshtë rrjet i disa organizatave). Organi më i lartë drejtues i fondacionit eshtë Bordi i Drejtoreve, i cili duhet të takohet të paktën njëherë në vit. Bordin e Drejtoreve e cakton themeluesi i fondacionit (vetëm përbërjen e parë), ndërsa në vazhdim anëtarët e Bordit zgjedhen nga vet Bordi. Anëtarët e organeve drejtuese duhet të térhiqen nga diskutimi dhe marrja e vendimit në rastet e konfliktit të interesit. Asnjë OShC nuk mund të angazhohet për mbledhje fondesh ose në fushata në mbështjete të partive politike ose kandidatëve përfunksione politike. Gjithashtu, OShC-të nuk mund të propozojnë, regjistrojnë ose të mbështesin kandidatët për poste publike. OShC-të nuk guxojnë të shpërndajnë të ardhura ose fitime për asnjë person, përvèç pagesës së arsyeshme për punën që e bëjnë për atë OShC. OShC-ja mund të angazhohet në aktivitetë ekonomike, mirëpo të gjitha pasuritë dhe të ardhurat duhet të përdoren për të mbështetur misionin e organizatës.

ÇKA PËRFSHIHET NË QEVERISJEN E BRENDSHME TË OShC-VE NË KOSOVË?

Sikurse në vende tjera, qeverisja e brendshme e OShC-ve në Kosovë bazohet në detyrime të jashtme ligjore dhe kontraktuale dhe parime të brendshme. Detyrimet e jashtme kryesisht përfshijnë kërkesat ligjore për OShC-të e regjistruesa në raport me strukturat formale të brendshme dhe obligimet për raportim të kategorive të ndryshme të organizatave, ndërsa parimet e brendshme përfshijnë sisteme të funksionimit të bazuara në vlera, statut, rregulllore, kode të mirësjelljes, etj. Shumica e detyrimeve ligjore dalin nga Ligji për Liri të Asociimit në OJQ, ndërsa parimet e brendshme përcaktohen kryesisht me dokumentet e brendshme të vet organizatave përkatëse.

Dokumentet e brendshme duhet të përcaktojnë parimet dhe rregullat kryesore të punës së organizatës si: misioni, organi më i lartë udhëheqës dhe raportet me strukturat tjera brenda organizatës, kompetencat dhe përgjegjësitet e secilit organ, mënyrën e vendim-marrjes, mandatin e organit më të lartë, numri minimal i takimeve vjetore, mënyra e thirrjes së takimeve, rregullat për menaxhim të konfliktit të interesit, rregullat e anëtarësimit, shuarjen e organizatës, etj.

Misioni për të cilin themelohet paraqet një ndër elementet kryesore të parimeve të qeverisjes së brendshme. Secila OShC duhet të themelohet për të synuar përmbrushjen e një misioni të caktuar, i cili duhet të jetë specifik. Varësisht nga misioni, secila OShC duhet të definojë llojin e aktiviteteve të cilat do të kontribuojnë në përmbrushjen e misionit.

Secila OShC duhet të ketë të përcaktuar qartë **mënyrën e vendim-marrjes**, në nivele të ndryshme. Për çështjet madhore të OShC-së, vendim-marrja eshtë kompetencë ekskluzive e organit më të lartë. Për çështjet të cilat mund të delegohen, vendimet mund të merren edhe nga organet e ndërmjetme (te shoqatat) apo stafi ekzekutiv. Zakonisht respektohet hierarkia: Kuvendi/Bordi i përcakton orientimet strategjike të organizatës, Drejtori Ekzekutiv udhëheq me organizatën në përgjithësi dhe mban përgjegjësi për vendimet e përditshme në nivel të organizatës, Menaxheri Financiar bashkë-vendos me Drejtorin Ekzekutiv për çështjet financiare, Udhëheqësit e Programeve bashkë-vendosin me Drejtorin Ekzekutiv për çështjet programore specifike e kështu me radhë.

Të gjitha OShC-të që shfrytëzojnë mjete financiare për aktivitetet e tyre, duhet të kenë **menaxhim financiar** të duhur. Në përgjithësi, duhet të respektohen parimet ndërkombëtare të kontabilitetit si dhe legjislacioni në fuqi në Kosovë. Secila OShC e regjistruar duhet të ketë xhirollogari bankare dhe të gjitha të hollat (donacionet) t'i pranojë vetëm nëpërmjet bankës. Gjithashtu duhet të synohet që të gjitha pagesat të bëhen nëpërmjet bankës, përveç shpenzimeve të imta të cilat është e pamundur të paguhen me bankë. Të gjitha pagesat duhet të bëhen vetëm në bazë të faturave të rregullta ose kontratave mbi shërbime, ndërsa secila pagesë duhet të autorizohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe Menaxheri Financiar. Për të gjitha transaksionet financiare duhet të mbahen librat e kontabilitetit (zakonisht në programe specifike financiare), ndërsa organizata duhet të prodhojë raporte të rregullta për të gjitha të hyrat dhe pagesat (minimumi një herë në vit). Raportet duhet t'i dorëzohen dhe të aprovohen nga organi më i lartë i organizatës, ndërsa preferohet që ato të jenë publike. Organizatat me Status të Përfitimit Publik që kanë qarkullim vjetor mbi 100,000 EUR janë të obliguara t'i nënshtronen auditimit vjetor nga auditorë të pavarur të certifikuar, ndërsa preferohet që edhe organizatat tjera të bëjnë auditime të rregullta të projekteve dhe të gjithë organizatës. Organizatat me qarkullim më të madh të mjeteve preferohet që të kenë Rregullore të veçantë financiare, në të cilën përcaktohen të gjitha rregullat e detajuara të procedimit financiar për të gjitha rastet e mundshme të të hyrave dhe pagesave.

Organizatat të cilat kanë staf të përhershëm duhet të përcaktojnë të gjitha **rregullat bazë të punës së stafit**, si p.sh. rekrutimi, orari i punës, pagesa, sjellja, konfidencialiteti, pushimet, të drejtat dhe obligimet e stafit, etj. Secili punëtor i angazhuar me orar të plotë ose gjysmë-orar duhet të ketë kontratën e punës, ku specifikohen qartë pozita, përgjegjësitet, detyrat e pozitës së caktuar, ndërsa Rregullorja e Punës është pjesë përbërëse e kontratës.

Bërja publike e veprimtarisë dhe mjeteve të shfrytëzuara është parim i përgjithshëm i qeverisjes së mirë, ndërsa niveli i hapjes për publikun dallon nga lloji dhe veprimtaria e organizatës.

CILAT JANË INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR ZBATIM?

Trupi kryesor përgjegjës për zbatimin e këtyre parimeve është organi më i lartë udhëheqës i organizatës, ku qeverisja e mirë bazohet në mirëbesimin ndërmjet hisedarëve tjerë dhe organizatës.

Duke njohur faktin që jo vetëm organizatat jo-qeveritare të regjistruara (OJQ-të) bëjnë pjesë në shoqëri civile, termi OShC u referohet të gjitha formave të organizuara të shoqërisë civile. Termi OJQ, në këtë dokument, përdoret vetëm në rastet kur flitet për dispozitat konkrete ligjore të cilat u referohen konkretisht organizatave jo-qeveritare të regjistruara (OJQ-ve).

CILAT JANË PARIMET KRYESORE TË QEVERISJES SË BRENDSHME TË OSCH-VE?

Edhe pse ka dallime varësisht nga lloji i organizatës, disa nga parimet kryesore të qeverisjes së brendshme janë: ekzistencia e një misioni të qartë dhe veprimtaria në kuadër të atij misioni, ekzistencia e strukturave të brendshme me përgjegjësi të ndara dhe të qarta, ndarja në mes të organeve udhëheqëse dhe menaxhmentit, menaxhimi i rregullt financier, transparenca dhe llogaridhënia ndaj hisedarëve, standardet etike të punës dhe sjelljes, etj.



Qendra ofron si dhe i përgjigjet çdo kërkeze për informacion për nevojat e organizatave të shoqërisë civile (OShC), qytetarëve të interesuar, institucioneve publike dhe organizatave donatore për zhvillimin e shoqërisë civile në Kosovë.

QËLLIMI I QENDRËS:

- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në demokratizimin e vendit
- Ngritja e kuptimit mbi rolin e shoqërisë civile në procesin e politikë-bërjes dhe vendim-marrjes
- Grumbullimi dhe shpërndarja e informacionit rreth sektorit të shoqërisë civile
- Krijimi i instrumenteve për mbledhjen dhe analizën e vazhdueshme të të dhënave për sektorin e shoqërisë civile dhe fusha të veçanta të këtij sektori
- Ngritja e kapaciteve të OShC-ve dhe institucioneve publike për bashkëpunimin ndërsektorial
- Promovimi dhe përkrahja e drejtpërdrejtë në qeverisjen e mirë të brendshme të OShC-ve

ÇKA OFRON QENDRA?

- **Deskun e informacionit** i cili i përgjigjet çdo kërkeze për informacion rreth sektorit të shoqërisë civile dhe pranon kërkesat e OShC-ve për trajnime, përkrahje dhe mentorim
- **Trajnime bazike dhe të avancuara** për pjesëtarët e OShC-ve, në baza të rregullta ose në bazë paraqitjes së kërkesës nga ana e OShC-ve
- **Shërbimin e këshillimit gjatë punës dhe mentorimit** që ofron këshillim dhe mentorim në punën e përditshme të OShC-ve në bazë të kërkesës së tyre
- **Këndin e informacionit** ku vizitorët mund të marrin informata rreth sektorit të shoqërisë civile dhe broshura e artikuj informues për këtë sektor
- **Këndin e leximit** që mund të presë deri në 10 vizitorë
- **Këndin e bibliotekës** ku vizitorët mund të gjejnë libra dhe artikuj nga fusha e zhvillimit të shoqërisë civile dhe procesit të integrimit europian
- **Sallën e pajisur** me të gjitha elementet me kapacitet deri në 25 persona

ORARI I PUNËS
e hënë – e premtë
10:00 deri 14:00



CILAT JANË RREGULLAT PËR VIZITORË?

Broshurat dhe fletushkat jepen falas për të gjithë vizitorët

Librat, butelinët dhe publikimet tjera mund të lexohen vetëm brenda Qendrës

Të gjithë të interesuarit për shërbimet e Qendrës duhet të kontaktojnë deskun e informacionit, me shkrim apo drejtpërdrejtë